REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENSIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr.Prot 807 Elbasan më 16 /02/2026

# RELACION

**Mbi dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin JANAR 2026**

**KËSHILLIT BASHKIAK**

*Të nderuar Këshilltarë,*

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar , nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike", paraqesim per miratim propozimin e familjeve qe do trajtohen nga fondi i kushtezuar.

**I.** Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin **JANAR 2026 , 256 familje** me një fond prej **1.199.691 lekë**.
Këto janë familje të varfra të cilat kanë aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike dhe për shkak se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, nuk janë kualifikuar përfitues të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit.
Këto janë kryesisht familje me një ose dy antarë. Pra këtu kemi familje të cilat janë me një anëtarë, si femrat ose meshkujt në moshë të madhe të pamartuar ose të divorcuar, të cilët kanë ose jo një ose dy fëmijë në ngarkim ; personat mbi moshë pune të cilët nuk kanë përfituar pension pleqërie .
Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.

| | | |
|---|---|---|
| Konceptoi: | Përgj Sektori | M.Duka |
| Pranoi: | Dr Përgjithshëm | D.Shuli |

**ZV/ KRYETARI**

**ARMAND SHEHU**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN**

Nr_______Prot Elbasan më____/02/ 2026

**PROJEKT – VENDIM**

Nr. ____ datë ____/02/2026

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin JANAR 2026**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar , nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike" Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/02/2026 pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Sherbimit Social

**VENDOSI**

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **JANAR 2026** për **256** familje me një fond prej **1.199.691** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

| | | |
|---|---|---|
| Konceptoi: | Përgj sektori | M.Duka |
| Pranoi : | Drejtor Dr Juridike | A.Hoxha |
| | Drejtor Dr Finance | A.Merkja |
| Miratoi: | Dr Përgjithshëm | D.Shuli |
| Konfirmoi: | Zv/Kryetar | A.Shehu |

**Sekretar i Këshillit Bashkiak** **Kryetar i Këshillit Bashkiak**

**Elsid Zyma** **Lutfi Lala**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENSIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr 896 Prot Elbasan më 16 /02/2026

**RELACION**

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin JANAR 2026**

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**Të nderuar Këshilltarë,**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar , ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" , V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

**Propozojmë:**

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin JANAR 2026 gjithsej 81 familje me një fond gjithsej 247.000 lekë .
   Këto janë familje shumë të varfëra të cilat nuk kanë mundësi të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike pasi për shkaqe të ndryshme sociale, shëndetësore dhe ekonomike, një anëtar madhor nuk është prezent gjatë aplikimit .
   Këto janë raste të grave të braktisura nga bashkëshortët e tyre dhe anasjelltas, familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të shëndetit mendor të cilët largohen nga banesa pa adresë fikse, familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të ndryshme sociale (alkooli, droga etj) të cilët nuk janë në gjendje të paraqiten në ditën e aplikimit të ndihmës ekonomike në sistem.

2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: Pergj sektori M.Duka
Pranoi: Dr Pergjithshem D.Shuli

**Zv/kryetari**

**Armand Shehu**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr_______Prot                                        Elbasan më____/02/ 2026

**PROJEKT - VENDIM**
Nr. _____ datë____/02/ 2026

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin JANAR 2026**

Bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", V.K.M nr. 597,datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"
Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/02/2026

**VENDOSI**

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin JANAR 2026 për 81 familje me një fond prej 247.000 lekë.
2 Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.
3 Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4 Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

| | | |
|---|---|---|
| Konceptoi: | Përgj sektori | M.Duka |
| Pranoi : | Drejtor Dr Juridike | A.Hoxha |
| | Drejtor Dr Finance | A.Merkja |
| Miratoi: | Dr Përgjithshëm | D.Shuli |
| Konfirmoi: | Zv/Kryetar | A.Shehu |

**Sekretar i Këshillit Bashkiak**
**Elsid Zyma**

**Kryetari i Këshillit Bashkiak**
**Lutfi Lala**

**BASHKIA ELBASAN**
**DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIAL**
**SEKTORI I VLERËSIMIT DHE PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE**
**DHE AFTËSISË SË KUFIZUAR**

# INFORMACION KRAHASUES PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR MUAJIN JANAR 2026

## I. Ndihma ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2026

| | | | |
|---|---|---|---|
| Janar | 256 familje | fondi | 1.199.691 |
| Dhjetor | 260 familje | fondi | 1.206.211 |

Për muajin Janar 2026 kemi 4 familje më pak se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi I kushtëzuar.

Fondi është 6.520 lekë më pak se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I kushtëzuar janë:

1. Sokol Dinja (riaplikon ne sistem)
2. Rudina Mema (nuk paraqitet)
3. Shpresa Qosja (nuk paraqitet)
4. Stela Kapurani (punesim)
5. Haxhire Prelepi (pension)
6. Fatmir Isufaj (nuk paraqitet)
7. Anila Feratozi (larguar jashte shtetit)
8. Hajrije Goguja (nuk paraqitet)
9. Artan Pema (nuk paraqitet)
10. Selim Hamza (riaplikon ne sistem)
11. Servet Kllogjri (riaplikon ne sistem)

## II. Ndihma ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Janar 2026

| | | | |
|---|---|---|---|
| Janar | 81 familje | fondi | 247.000 |
| Dhjetor | 83 familje | fondi | 249.000 |

Për muajin Janar 2026 kemi 2 familje më pak se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë.

Fondi i shpenzuar është 2.000 lekë më pak se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi I Bashkisë janë :

1. Bujar Sadikja (riaplikon nè sistem)
2. Hekurane Harari (nuk u paraqit)
3. Valbona Musabelli (riaplikon nè sistem)
4. Donika Gjuni (larguar jashte shtetit)
5. Shpresa Shqau (larguar ne Lleshan)
6. Petrit Leçoj (riaplikon ne sistem)
7. Esmeralda Vllahi (riaplikon ne sistem)
8. Mehedi Cani (riaplikon ne sistem)
9. Venemin Bezhani (riaplikon ne sistem)
10. Ervin Preçi (riaplikon ne sistem)
11. Xhemile Boshku (riaplikon ne sistem)

**Konceptoi**

**Specialiste Ermira Dika**

**Pèrgjegjèse Sektori**

**Miranda Duka**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E BUXHET-FINANCËS

Nr. 714 Prot. Elbasan më 12.02.2026

# RELACION

**Mbi transferimin e aseteve, nga institucioni i Bashkisë Elbasan në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SH.A.**

Drejtuar: **KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN**

Të nderuar Këshilltarë,

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), Ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), Ligjit Nr.7661, datë 19.01.1993 "Për kontabilitetin", V.K.M. Nr.248, datë 10.04.1998 "Për miratimin e planit kontabël të organeve të pushtetit lokal dhe institucioneve qendrore" (i ndryshuar), Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" (i ndryshuar), Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" (i ndryshuar), propozojmë të kryhet transferimi i aseteve, nga institucioni i Bashkisë Elbasan në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan SH.A. Këto transferime të pasqyrohen në pasqyrat financiare të vitit 2025.
Bashkangjitur lista përkatëse sipas llogarive ekonomike.

Konceptoi: Përgjegjës Ornela Shehu
Pranoi: Drejt.Buxhet-Financës Alketa Merkja
Miratoi: Drejt.Përgjithshëm Servo Mehmeti

**KRYETARI**
**Gledian Llatja**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**
**ZV/KRYETARI**
**Klaudia Krasnika**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

| Nr | Emertimi i objektit | Shuma | Kodi | Analiza |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Ndertim rrjeti KUZ ne zonat informale | 68,807,741 | P520AAA | 2313600 |
| 2 | Mbikqyrje "Ndertim rrjeti KUZ ne zonat informale" | 1,169,550 | P520AAA | 2313600 |
| 3 | Kolaudim "Ndertim rrjeti KUZ ne zonat informale" | 100,000 | P520AAA | 2313600 |
| | **Shuma** | **70,077,291** | | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _______ Prot. Elbasan, më ___.02.2026

**PROJEKT VENDIM**

**Nr. ______ datë ___.02.2026**

***"Për transferimin e aseteve, nga Bashkia Elbasan, në Shoqërinë Rajonale "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sh.a."***

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës ___.02.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, pasi mori në shqyrtim materialin e përgatitur nga Drejtoria e Buxhet - Financës në bashki, për transferimin e aseteve, nga Bashkia Elbasan, në Shoqërinë Rajonale "Ujësjellës Kanalizime Elbasan" sh.a., mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), në ligjin nr. 9228 datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" (i ndryshuar), në ligjin nr. 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), në ligjin nr. 10296 datë 08.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" (i ndryshuar), në VKM nr. 248 datë 10.4.1998 "Për miratimin e Planit Kontabël të organeve të pushtetit lokal dhe institucioneve qendrore" (i ndryshuar), si dhe në Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" (i ndryshuar);

**VENDOSI:**

1. Të miratojë transferimin e aseteve, nga Bashkia Elbasan, në Shoqërinë Rajonale "Ujësjellës Kanalizime" sh.a., sipas tabelës së mëposhtme:

| *Nr.* | *Llogaria ekonomike* | *Emërtimi* | *Vlera* | *Institucioni ku transferohen* |
|---|---|---|---|---|
| 1 | 2136100 | "Ndërtim rrjeti KUZ në zonat informale" | 68,807,741 | Shoqëria Rajonale "UKE" sh.a. |
| 2 | 2136100 | Mbikqyrje "Ndërtim rrjeti KUZ në zonat informale" | 1,169,550 | |
| 3 | 2136100 | Kolaudim "Ndërtim rrjeti KUZ në zonat informale" | 100,000 | |
| | | ***Shuma*** | **70,077,291** | |

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Buxhet - Financës.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Elsid Zyma**

**KRYETARI**

**Lutfi Lala**

*Konceptoi:*

*Drejtori i Buxhet - Financës:* *A. Merkja*

*Drejtori Juridik dhe Informacionit:* *A. Hoxha*

*Pranoi:*

*Drejtori i Përgjithshëm i SHM:* *S. Mehmeti*

*Miratoi:*

*Zv/kryetare:* *K. Krasnika*

**BASHKIA ELBASAN**
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE**
**DREJTORIA E PYJEVE DHE BUJQËSISË**

**Nr 766 prot** **Elbasan më 16 /02/2026**

# RELACION MBI PROJEKT- VENDIMIN

**Për miratimin e pikave, për marrjen e materialeve inerte, për plotësimin e nevojave të banorëve dhe mirmbajtjes së rrugëve rurale të Bashkisë Elbasan.**

Të nderuar këshilltarë !

Mbështetur në nenin nr. 26 të ligjit nr. 57/2020, datë 30/04/2020 "Për pyjet"; ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; VKM nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive" të ndryshuar; VKM nr. 559, datë 29.7.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", Bashkia Elbasan nëpërmjet këtij Projekt Vendimi kërkon të formalizojë për një periudhë 5 vjeçare të gjitha pikat për marrjen e inerteve, për plotësimin e nevojave të banorëve dhe mirmbajtjen e rrugëve të ndryshme rurale në të gjithë teritorin administrativ të saj.
Meqenëse Bashkia Elbasan, ka një shtrirje rurale të konsiderueshme me rreth 12 Njësi Administrative (Gjinar, Zavalinë, Tregan, Shushicë, Gjergjan, Shirgjan, Paper, Gracen, Bradashesh, Funar,Labinot Mal, Labinot Fushë), të cilët në total përfshijnë teritorin e 117 fshatrave.
Nisur nga ky tregues sinjifikativ, në të cilët fshatrat lidhen me një rrjet rrugësh rurale me njësite administrative nga njëra anë dhe fshatrat midis tyre nga ana tjetër, lind domosdoshmëria e mirmbajtjes së tyre duke planifikuar fonde dhe fuqi punëtore gjatë gjithë periudhës së vitit.
Një nga zërat më të rëndësishëm që bashkia tregon vëmendje të vazhdueshme lidhur me mirmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve rurale (të pashtruara me asfalt) është dhe hedhja e materialeve inerte, sistemimi tyre, për karikimin e shumë segmenteve rrugore në të cilën lind domosdoshmëria të hidhën këto materiale inerte për evitimin apo bllokimin e lëvizjes së mjeteve motorike në periudhën me reshje shiu. Duhet theksuar fakti se gërmimi dhe marrja e materialeve inerte që përdoren për mirmbajtjen e rrugëve rurale bëhet kryesisht në fondin pyjor që administrohet dhe është në pronësi të bashkisë, por në disa raste në fond publik që nuk është e admnistruar si fond pyjor.
Mirëpo sqarojmë faktin se gërmimi dhe marrja e materialeve inerte pa leje në fondin pyjor/publik, konsiderohet kundravajtje administrative (kur pasojat janë të lehta) dhe sipas lidhit 57/2020 'Për pyjet" neni 36, dënohet me gjobë sipas parashikimeve të këtij ligji.

Gjithashtu shumë banorë që janë rezident në fshatrat e njësive administrative, herë pas here kanë paraqitur kërkesat për të marrë materiale inerte për plotësimin e nevojave pranë banesave të tyre, kundrejt kryerjes së pagesës sipas tarifave të VKM nr. 559, datë 29.7.2022 neni 5 shtojca nr. 3 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore e jo drusore pyjore".
Bashkia Elbasan dhe më herët ka aplikuar këtë procedurë të tillë në të cilën ka miratuar pikat për marrjen e materialeve inerte në teritorin rural të sajë, për qëllimin e mirmbajtjes së rrugëve rurale, me afat kohor prej 5 vitesh.
Nisur dhe nga fakti që tashmë bashkia është jashtë afateve kohore të përdorimit të pikave të marrjes së inerteve të miratuara më parë e bën dhe më të domosdoshme kryerjen e këtij studimi dhe më pas marrjen e vendimit për miratim nga Këshilli Bashkiak.
Në kryerjen e këtij studimi kanë marrë pjesë përveçëse specialistët e pyjeve të Drejtorisë së Pyjeve dhe Bujqësisë pranë Agjencisë së Shërbimeve Publike Rurale por dhe të gjithë Administratorët e Njesive Administrative të Bashkisë Elbasan duke u konsultuar paraprakisht me kryetarët e fshatrave dhe banorët e tyre mbi mundësitë që në teritorin e secilit fshat apo të disa fshatrave sëbashku shihet mundësia e marrjes së materialeve inerte për përdorim për nevojat e tyre familjare apo për përdorim nga vetë bashkia, nëpërmjet strukturave të specializuara pranë sajë, për mirmbajtjen e rrugeve rurale në të gjithë teritorin e bashkisë.
Duhet të theksojmë faktin se marrja e materialeve inerte, pas miratimit nga Këshilli Bashkiak, nuk do të jetë objekt i furnizimit të subjekteve private për qëllime tregtare apo marrja e këtyre materialeve nga subjekte të cilat kanë fituar dhe lidhur kontrata publike të cilat në aktivitetin e tyre kontraktual duhet të përdorin këto materiale inerte.
Bashkangjitur këtij relacioni do të gjeni dhe tabelën me të dhënat e detajuara të marra në terren për ç'do njësi administrative rurale të përfshirë në këtë studim.

Sa më sipër, ***kërkojmë nga ana Juaj, miratimin e pikave për marrjen e materialeve inerte, për plotësimin e nevojave të banorëve dhe mirmbajtjes së rrugëve rurale të Bashkisë Elbasan, sipas listë bashkangjitur këtij relacioni.***

Ju faleminderit për mirkuptimin !

**KRYETARI**
**Gledian Llatja**

**ME URDHËR E POROSI**
**ZV/KRYETARI**
**Klaudia Krasnika**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ELBASAN

BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE
DREJTORIA E PYJEVE DHE BUJQËSISË

## PIKAT E MARRJES SË MATERIALEVE INERTE
## PËR NEVOJAT E BANORËVE DHE MIRMBAJTJEN E RRUGËVE RURALE TË BASHKISË ELBASAN

| Subjekti përfitues | Nj. Administ. | Fshati | Afati | Emri i Vendit | Parc. Nr. | Ek. Pyjore | Sip.Ha | Kordinatat Gjeografike (GPS) | | Pronësia | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | x | y | | |
| 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 |
| Bashkia Elbasan | **Shirgjan** | Mjekës | 5 | Prroi i Vrushës | | | 0,3 | 41°04'49.15" | 20°03'53.39" | Publik | |
| | " | Bujqës | 5 | Lagja Molëve | 23/c | Zalli Shkumbin | 0,3 | 41°04'48.16" | 20°02'29.68" | Bshkiak | |
| | " | Jagodinë | 5 | Lagja Hysallarëve | 26/d | " | 0,3 | 41°04'26.39" | 20°01'04.27" | " | |
| | **Shushicë** | Shushicë | 5 | Ish Gurorja | 108/a | Polis-Vasjan | 0,3 | 41°05'49.98" | 20°07'40.55" | " | |
| | " | Fush-Bull | 5 | Tek Mulliri | 37 | " | 0,2 | 41°06'56.52" | 20°11'23.95" | " | |
| | " | Shelcan | 5 | Mbi 2 Çezmat | 62/a | " | 0,2 | 41°03'04.81" | 20°08'34.28" | " | |
| | " | Polis-Valë | 5 | Ura Polis-Valë | 45/a | " | 0,2 | 41°09 28.30" | 20°13'27.34" | " | |
| | " | Polis i Vogël | 5 | Ura Polis i Vogël | 57/b | " | 0,2 | 41°08'55.78" | 20°10'03.75" | " | |
| | " | Mlizë | 5 | Rruga Hidallarëve | 75/a | Shpat-Shtërmen | 0,2 | 41°03'45.29" | 20°06'19.15" | " | |
| | **Labinot-Mal** | Guri i Zi | 5 | Tek Shemat | 82/b | Zaranikë | 0,2 | 41°12'02.16" | 20°06'57.72" | " | |
| | " | Guri i Zi | 5 | Mbi Gështenjat | 72/a | " | 0,2 | 41°12'17.8" | 20°07'03.2" | " | |
| | " | Benë | 5 | Qafë Qinam | 55/c | " | 0,2 | 41°14'14.71" | 20°06'50.54" | " | |
| | " | Benë | 5 | Kroi i Kizës | 44/a | " | 0,1 | 41°14'57.61" | 20°05'40.51" | " | |
| | " | Qafë | 5 | Kodra e Jevgut | 63/b | Shmil | 0,2 | 41°13'37.49" | 20°10'07.11" | " | |
| | " | Qerret | 5 | Qafa e Humit | 101/h | " | 0,2 | 41°12'27.85" | 20°11'43.25" | " | |
| | " | Qerret | 5 | Qafë Agë | 79/b | " | 0,15 | 41°14'20.45" | 20°10'42.85" | " | |
| | " | Lugaxhi | 5 | Tek Meli | 90/a | " | 0,2 | 41°15'06.64" | 20°11'15.81" | " | |
| | " | Sericë | 5 | Prroi Pahait | 90/d | Labinot | 0,2 | 41°11'18.05" | 20°11'47.4" | " | |
| | " | Lamollë | 5 | Faqet Lamollë | 75/d | " | 0,15 | 41°10'26.5" | 20°10'18.4" | " | |
| | **Gjinar** | Gjinar | 5 | Mbi Val | 16/b | F.kuqe-Zavalinë | 0,2 | 41°01'44.23" | 20°12'04.95" | " | |
| | " | Gjinar | 5 | Ura e Shqahut | 14/a | Gjinar-Zavalinë | 0,2 | 41°01'28.04" | 20°11'39.21" | " | |
| | " | Pashtresh | 5 | Gësterë | 48/b | " | 0,2 | 41°00'29.61" | 20°14'15.77" | " | |
| | " | Derstilë | 5 | Derstilë | 3/d | F.kuqe-Zavalinë | 0,4 | 41°02'36.65" | 20°11'25.53" | " | |
| | " | Pobrat | 5 | Kopaçja | 61/a | Shpat-Shtërmen | 0,2 | 41°02'36.78" | 20°08'46.4" | " | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 25 | " | Lleshan | 5 | Sergozë | 65/b | " | 0,2 | 41°03'02.6" | 20°11'12.38" | " |
| 26 | " | Sterstan | 5 | Fagu | 33/d | Gostimë-Koprik | 0,2 | 41°00'03.84" | 20°07'14.54" | " |
| 27 | " | Kafërr | 5 | Guri i Kuq | 86/a | " | 0,2 | 40°57'53.57" | 20°09'20.63" | " |
| 28 | " | Kafërr | 5 | Breg Shimplak | 38/g | Gjinar-Zavalinë | 0,2 | 40°58'49.02" | 20°10'22.95" | " |
| 29 | " | Kafërr | 5 | Zalli Dervishaj | 36/o | " | 0,2 | 40°57'54.44" | 20°10'24.42" | " |
| 30 | " | Xibresh | 5 | Qafë Bokrrinë | 52/a | " | 0,2 | 40°58'45.96" | 20°12'01.64" | " |
| 31 | " | Valësh | 5 | Ura e Fangut | 17/a | " | 0,2 | 41°00'28.28" | 20°11'0.98" | " |
| 32 | " | Valësh | 5 | Prroi Vildesës | 50/a | " | 0,1 | 40°59'23.3" | 20°11'40.17" | " |
| 33 | **Tregan** | Muçan | 5 | Çekrezët | 53/b | Gostimë-Koprik | 0,4 | 41°00'12.32" | 20°06'34.94" | " |
| 34 | " | Shinavlash | 5 | Çekrezët | 53/b | " | | " | " | " |
| 35 | " | Shilbater | 5 | Çekrezët | 53/b | " | | " | " | " |
| 36 | " | Kyçyk | 5 | Çekrezët | 53/b | " | | " | " | " |
| 37 | " | Çikallesh | 5 | Çekrezët | 53/b | " | | " | " | " |
| 38 | " | Gurishtë | 5 | Çekrezët | 53/b | " | | " | " | " |
| 39 | " | Blerimas | 5 | Zalli Thatë | 38/a | " | 0,3 | 40°58'29.82" | 20°08'12.67" | " |
| 40 | " | Kaçivel | 5 | Zalli Thatë | 38/a | " | | " | " | " |
| 41 | " | Bizhdan | 5 | Zalli Thatë | 38/a | " | | " | " | " |
| 42 | " | Tregan | 5 | Bathas-Prroi i Zi | | | 0,2 | 41°01'48.84" | 20°04'49.64" | Publik |
| 43 | " | Tudan | 5 | Varezat Tollumëve | 78/b | Shpat-Shtërmen | 0,2 | 41°03'11.79" | 20°07'32.71" | Bshkiak |
| 44 | " | Trepsenisht | 5 | Varezat Tollumëve | 78/b | " | | " | " | " |
| 45 | " | Trepsenisht | 5 | Lagja e Idajëve | 76/b | " | 0,2 | 41°03'44.7" | 20°06'18.56" | " |
| 46 | **Gjergjan** | Bujarës | 5 | Tek ish Mulliri | 4/b | " | 0,3 | 41°00'35.89" | 20°03'04.78" | " |
| 47 | **Labinot-Fushë** | Xibrakë | 5 | Skrepi Shkallet | 90/b | Labinot | 0,2 | 41°11'18.11" | 20°11'47.27" | " |
| 48 | " | Xibrakë | 5 | Prroi Grabozës | 92/a | " | 0,3 | 41°10'12.43" | 20°11'42.69" | " |
| 49 | " | Labinot-Fushë | 5 | Ura e Polisit | | | 0,2 | 41°08'52.49" | 20°09'55.69" | Publik |
| 50 | " | Griqan-Sipër | 5 | Kthesa Muratet | 10/d | Labinot | 0,2 | 41°09'08.12" | 20°07'39.25" | Bshkiak |
| 51 | " | Griqan-Poshtë | 5 | Kthesa Muratet | 10/d | " | | " | " | " |
| 52 | " | Mengël | 5 | Lumi Shkumbin | | | 0,2 | 41°07'30.72" | 20°08'08.39" | Publik |
| 53 | " | Godolesh | 5 | Prroi Manazderes | 104/c | Zaranikë | 0,3 | 41°08'48.46" | 20°04'51.14" | Bshkiak |
| 54 | **Funar** | Cërunjë | 5 | Fusha e Madhe | 32/b | " | 0,2 | 41°13'23.9" | 20°05'02.29" | " |
| 55 | " | Cërunjë | 5 | Arat e Sulet | 47/b | " | 0,3 | 41°14'20.37" | 20°05'37.99" | " |
| 56 | " | Mollagjesh | 5 | Zalli i Korrës | 33/g | Zalli i Korrës | 0,2 | 41°14'01.86" | 20°02'28.2" | " |
| 57 | " | Korrë | 5 | Zalli i Korrës | 33/g | " | | " | " | " |
| 58 | " | Preçë-Poshtme | 5 | Faqet e Folonjës | 23/b | Zaranikë | 0,2 | 41°10'32.87" | 20°05'0.33" | " |
| 59 | " | Preçë-Sipërme | 5 | Faqet e Folonjës | 23/b | " | | " | " | " |
| 60 | **Zavalinë** | Seltë | 5 | Garxhë | 49/c | F.kuqe-Zavalinë | 0,2 | 41°00'29.62" | 20°14'00" | " |
| 61 | " | Burrishtë | 5 | Garxhë | 49/c | " | | " | " | " |
| 62 | " | Nezhan | 5 | Garxhë | 49/c | " | | " | " | " |

**Bashkia Elbasan**

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 63 | " | Zavalinë | 5 | Tek Mulliri | 101/c | " | 0,2 | 40°59'05.64" | 20°17'48.05" | " |
| 64 | " | Kamiçan | 5 | Tek Mulliri | 101/c | " | | " | " | " |
| 65 | " | Joronisht | 5 | Tek Mulliri | 101/c | " | | " | " | " |
| 66 | **Gracen** | Gjormë | 5 | Prroi Kozanit | 65/b | Kushë-2 | 0,3 | 41°08'54.55" | 20°00'40.48" | " |
| 67 | " | Dopaj | 5 | Prroi Kozanit | 65/b | " | | " | " | " |
| 68 | " | Shingjin | 5 | Prroi Kozanit | 65/b | " | | " | " | " |
| 69 | " | Mamël | 5 | Prroi Kozanit | 65/b | " | | " | " | " |
| 70 | " | Mamël | 5 | Karburanti Petresh | 176/a | Papër-Sollak | 0,2 | 41°06'43.29" | 19°59'35.44" | " |
| 71 | " | Gracen | 5 | Karburanti Petresh | 176/a | " | | " | " | " |
| 72 | " | Pajengë | 5 | Karburanti Petresh | 176/a | " | | " | " | " |
| 73 | " | Plangaricë | 5 | Tek Çullhajt | 81/a | " | 0,2 | 41°10'33.6" | 19°54'26.26" | " |
| 74 | " | Bodin | 5 | Tek Çullhajt | 81/a | " | | " | " | " |
| 75 | " | Tërbaç | 5 | Zhurës | 99/b | " | 0,2 | 41°09'24.53" | 19°55'58.61" | " |
| 76 | **Bradashesh** | Letan | 5 | Guri i Letanit | 6/e | Zaranikë | 0,6 | 41°09'19.8" | 20°02'49.04" | " |
| 77 | " | Balëz Posht. | 5 | Guri i Letanit | 6/e | " | | " | " | " |
| 78 | " | Rrilë | 5 | Prroi Zaranikë | 22/d | " | 0,3 | 41°09'26.14" | 20°04'29.26" | " |
| 79 | " | Karakullak | 5 | Kushë | | | 0,5 | 41°06'39.89" | 20°01'47.0" | Publik |
| 80 | " | Shijon | 5 | Kushë | | | | " | " | " |
| 81 | " | Bradashesh | 5 | Kushë | | | | " | " | " |
| 82 | " | Reçan | 5 | Shtëmaj | 64/d | Kushë-2 | 0,4 | 41°08'25.93" | 20°00'43.93" | Bshkiak |
| 83 | " | Kozan | 5 | Shtëmaj | 64/d | " | | " | " | " |
| 84 | " | Shtëmaj | 5 | Shtëmaj | 64/d | " | | " | " | " |
| 85 | " | Ulëm | 5 | Shtëmaj | 64/d | " | | " | " | " |
| 86 | " | Shëmill | 5 | Rruga Shëmill | 176/a | Papër-Sollak | 0,4 | 41°06'09.72" | 20°00'13.16" | " |
| 87 | " | Fikas | 5 | Rruga Shëmill | 176/a | " | | " | " | " |
| 88 | " | Petresh | 5 | Mbi Karburant | 176/a | " | 0,2 | 41°06'43.29" | 19°59'35.44" | " |
| 89 | **Papër** | Papër | 5 | Zalli tek Subasht | 175/b | " | 0,5 | 41°03'30.0" | 19°57'07.14" | " |
| 90 | " | Pajun | 5 | Zalli Pajun | 14/b | " | 0,3 | 41°05'25.81" | 19°56'00.2" | " |
| 91 | " | Papër-Sollak | 5 | Mbi Urë | 109/b | " | 0,3 | 41°07'06.99" | 19°55'12.99" | " |
| 92 | " | Bizhutë | 5 | Kthesa e Damës | 170/a | " | 0,2 | 41°04'44.87" | 19°57'25.91" | " |
| | **Shuma:** | | | | | | **15,6** | | | |

**Për Drejtorinë e Pyjeve dhe Bujqësisë**

**Specialisti Menaxhimit**
**Qemal Poka**

**P/Sektorit Menaxhimit**
**Jakov Bodurri**

**DREJTORI**
**Eraldo Hazizolli**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

**PROJEKT VENDIM**

**Nr. _____ datë: ___.___.2026**

**PËR MIRATIMIN E PIKAVE PËR MARRJEN E INERTEVE PËR PLOTËSIMIN E NEVOJAVE TË BANORËVE DHE MIRMBAJTJES SË RRUGËVE RURALE TË BASHKISË ELBASAN.**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; V.K.M nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive" të ndryshuar; ligjit mr. 57/2020 "Për pyjet" neni 26.

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I**

1. Të miratojë pikat, për marrjen e materialeve inerte, për plotësimin e nevojave të banorëve dhe mirmbajtjen e rrugëve rurale të Bashkisë Elbasan, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi".

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve dhe Bujqësisë pranë A.SH.P.R.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

| | |
|---|---|
| **Sekretari i Këshillit Bashkiak** | **KRYETARI** |
| **Elsid Zyma** | **Lutfi Lala** |

*Konceptoi:* Qemal Poka

*Pranoi:* Jakov Bodurri

*Miratoi:* Eraldo Hazizolli

*Konfirmoi:* Arben Hoxha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA ELBASAN**
**AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE RURALE**
**DREJTORIA E PYJEVE DHE BUJQËSISË**

*Nr.* 765 *Prot.* *Elbasan, më* 16 . 02 . *2026*

# RELACION

## "PËR DHËNIEN E FONDIT PYJOR NË PËRDORIM"
## PËR QËLLIME ARGËTIMI, SHËNDETËSORE, SHOQËRORE VEPRIMTARI TURISTIKE KAMPINGJE DHE AGROPYLLTARI

***Të nderuar Këshilltar!***

Struktura e Shërbimit Pyjor pranë Bashkisë Elbasan, duke u bazuar në prioritetet e Bashkisë Elbasan për zhvillimin ekonomik si dhe në bazë të legjislacionit në fuqi për sipërfaqet pyjore në të cilat mund të ushtrohet veprimtari ekonomike në fondin pyjor kombëtar, i vlerëson veprimtaritë e propozuara mësipërme në përputhshmëri me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, parimet për zhvillimin e qëndrueshëm silvikulturor dhe biologjik të ekosistemit, si dhe mirëadministrimin e tokës publike. Duke qenë dhe si prioritet i qeverisë për mbështetjen e individëve dhe rimëkembjen e zonave malore me anë të zhvillimit turistik për të thithur investime të reja, ne hapim rrugën duke përcaktuar sipërfaqet pyjore ku mund të ketë interes nga bizneset dhe investitorë të ndryshëm në fushën e turizmit.

Strukturë jonë e orientuar në politikat e Qeverisë së Shqipërisë për mbrojtjen e tokës publike dhe rritjen e të ardhurave për bashkinë të cilat përkthehen në investime në fondin pyjor, propozon dhënien në përdorim të tokës pyjore për zhvillimin e vepritarivë: *Për qëllime argëtimi, shëndetësore, shoqërore, veprimtari turistike kampingje dhe agropylltari.* Veprimtaritë e mësipërme do të ketë një ndikim pozitiv për të ardhmen për gjenerimin e të ardhurave për komunitetin rrethues, sigurimin e vendeve te reja te punes, etj.

**Baza ligjore e aplikueshem:**

- Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
- Ligjit nr. 57/2020, datë 30.4.2020 "Për pyjet", i ndryshuar;
- Ligjit nr. 8318, datë 01.04.1998 "Për dhënien me qera të tokës bujqësore, pyjore të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore", i ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Ministave nr. 433, dt.8.6.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike…", i ndryshuar;
- Vendimit të Këshillit të Ministave nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", i nsryshuar;
- Udhëzimi i Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik";
- Parimet bazë të Silvikulturës.

**Në propozimin për dhënien e fondit pyjor në përdorim është mbajtur parasysh:**

Veprimtaria ekonomike për dhënien e fondit pyjor në përdorim - Për qëllime argëtimi, shëndetësore, shoqërore, veprimtari turistike kampingje dhe agropylltari nuk dëmton ekosistemin, por do të ndërtohen struktura akomoduese me bazë druri të përkohëshme dhe do të ndikojnë në rritjen e zhvillimit ekonomik nëpërmjet punësimit dhe vizitorëve të ndryshëm vendas dhe të huaj.

Këto sipërfaqe pyjore nuk bëjnë pjesë në rrjetin e Zonave të Mbrojtura.

**Përshkrim i shkurtër i vendndodhjes, karakteristikave stacionale dhe rivlerësime**

N/ngastrat pyjore nr. 6/b, 24/b, 21/b dhe 23/a gjenden në ekonominë pyjore "Fushëkuqe-Zavalinë"; N/ngastra pyjore nr. 11/c ndodhet në ekonominë pyjore "Gjinar-Zavalinë"; N/ngastra nr.26/c ndodhet në ekonominë pyjore "Shpat 1 &2" brenda kufirit administrativ të njësisë admistrative Gjinar. Jo pa qëllim janë propozuar këto sipërfaqe pyjore për tu dhënë në përdorim me kontratë qiraje për aktivitet turistik, pasi siç të gjithë jemi në dijeni Gjinari rrethohet nga një peisazh malor, ku gërshetohen pyjet, natyra e bukur dhe trashëgimia kulturore e kulinare. Pasuritë natyrore të fshatit Gjinar e kanë ridimensionuar atë si xhevahirin natyror të qytetit të Elbasanit.

Gjinari prej vitesh tërheq mijëra vizitorë në të katër stinët e vitit pasi ofron mundësi argëtimi të shumta si hiking, kamping, ekspedita studimore apo sporte të ndryshme si rally-it etj. Prandaj potenciali dhe interesi për zhvillimin e turizmit malor është shumë i lartë.

**Turizmi Malor dhe Ekoturizmi**

**Potencial:**

- Peizazhe të bukura, pyje të dendur, ajër i pastër – tërheqëse për turistë vendas dhe të huaj.
- Afërsia me Elbasanin dhe Tiranën e bën lehtësisht të aksesueshme.
- Tregje me **produkte bio** si: mjaltë, gështenja, boronica, çajra malorë.

**Zhvillim:**

- Zhvillimi i **bujtinave familjare** dhe promovimi i turizmit rural.
- Krijimi i shtigjeve për **ecje, biçikletë malore, kamping dhe alpinizëm**.
- Organizimi i eventeve vjetore *(festa e Miqtë e Malit, panaire me produkte lokale)*.

Këto toka janë siperfaqe pylli me Pishë të Zezë ku në siperfaqe të pakta atakohen celtira. Ndodhen shumë pranë qendrës së Gjinarit dhe kanë akses shumë të mirë infrastrukturor. Pronat ndodhen në lartësinë mbidetare rreth 1000-1200 metra mbi nivelin e detit. Me klime të ashpër mesdhetare, në tre muajt e vitit rri e mbuluar nga bora, por kohët e fundit me ndryshimin e kushteve atmosferike bora po bie më rrallë. Sipërfaqja e përgjithëshme e propozuar për tu dhënë në përdorim për qëllime turistike është **10,39** ha e shpërndarë në n/ngastrat e mësipërme *(sipas tabelës bashkëlidhur këtij relacioni).* Këto zona nuk kanë konflikte pasurore dhe janë pronë publike e bashkisë Elbasan për këtë qëllim plotësojnë të gjithë kushtet dhe objektivat e duhura për tu dhënë në përdorim palëve të treta kundrejt pagesave përkatëse.

Gjithashtu një sipërfaqe tjetër mjaft e lakmueshme për shumë subjekte dhe investitore të ndryshëm është n/ngastra pyjore nr. 10/a, 11/a dhe 15/b në ekonominë pyjore Labinot.

Këto sipërfaqe përbëhen nga pyll shkurrë me shkozë, mret dhe shkurrë të tjera por duke qënë në afërsi të qytetit të Elbasanit përbën interes të lartë për subjekte të ndryshëm për zhvillimin e ekoturizmit *(ndërtimin e bujtinave dhe kampingjeve të ndryshme me bazë druri të çmontueshme dhe agropylltari).*

Këto zona nuk janë shumë të zhvilluara dhe investimi nga palë të treta do ti shtonte një vlerë tjeter social-ekonomike kësaj zone. Shkurret janë pothuajse të degraduara vende-vende me hapsira të bollshme

për instalimin e kampingjeve të përkohshëm. Lartësia mbidetare e këtyre zonave është rreth 400-500 m mbi nivelin e detit. Infrastruktura është e aksesueshme përmes këtzre dy ngastrave.

Mbi arsyetimin e mësipërm propozojme që te jepen në perdorim një siperfaqja prej **6 ha** "Për qëllime argëtimi, shëndetësore, shoqërore dhe veprimtari turistike kampingje dhe agropylltari" sipas tabelës bashkëlidhur.

